



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03/02/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Xhemajl BUZUKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
CC:	z. Xhavit DAKAJ Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin “Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë”



I nderuar z. BUZUKU,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin “Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë” me nr. të prokurimit: 208-13-068-511 Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT ka përgatitur “ Njoftimin për Kontratë ” me titull “Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë ” me nr. Prokurimi 208 -13-068-511, e cila është publikuar në KRPP më datë. 10/10/2013, me Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit sipas Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftim për Kontratë” tek ”Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” pika e parë kërkohet: Qarkullim financiar për tri vitet e fundit (2010,2011 dhe 2012) të jetë minimum 6.000.000.00 € dëshmi: nga një apo më shumë banka për qarkullim financiar të licencuara në Kosovë (2010-2012) në rast konzorciumi lideri duhet të ketë jo më pak se 70 % të qarkullimit.

Po ashtu tek “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale” pika e) është kërkuar: Lista e punëve të kryera në lëmin e ndërtimit të lartë minimum 6 milion euro në tri vitet e fundit 2010-2012 dhe se paku dy kontrata të ngjashme (në ndërtim të lartë) të përfunduara në 3 vitet e fundit të jenë në vlerë minimum sa vlera e ofertës, dhe ti bashkëngjiten kopjet e kontratave dhe referencave - asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkëngjitur referenca për kryerjen e punëve. Të gjitha kontratat dhe referencat me operator privat llogariten vetëm nëse argumentohet mbyllja e kontratës me transaksione bankare. Lideri duhet të ketë jo më pak se 70%. Kriteret e lartë cekura të rubrikës ”Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” dhe “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale” siç janë përshkruar në “Njoftimin për Kontratë” janë kritere diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë dhe mund të favorizojnë Operatorët Ekonomik të caktuar.

Autoriteti Kontraktues, më datë 29/10/2013 ka bërë hapjen e ofertave dhe në të njëjtën datë është nxjerrë vendimi me numër:5/1-2217 për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave. Në pikën II të këtij vendimi thuhet: Komisioni do të punoj në përbërje të plotë, në objektin e MASHT-it, duke filluar me punë sa më parë. Pavarësisht kësaj, Komisioni nuk ka filluar vlerësimin para datës 27/01/2014 derisa vlefshmëria e tenderit është 90 ditë (pika 21.1 në DT). Pra, Komisioni ka filluar vlerësimin në fundin e vlefshmërisë së tenderit. Bazuar në Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik, pika 35.2. thuhet: ***Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.***

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale, nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 si dhe pikës 35.2 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe shmangien e praktikave të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!